

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË  
DEPARTAMENTI I ANATOMISË PATOLOGJIKE  
DHE MJEKËSISE LIGJORE**



UNIVERSITETI I MJEKËSISE, TIRANE

**STUDIM KLINIK-MORFOLOGJIK I TUMOREVE TË  
TRURIT NË MOSHËN PEDIATRIKE**

**Disertacion  
Për Marrjen e Gradës Shkencore**

**DOKTOR**

**Disertanti:**

**Arben Preza**

**Udhëheqës Shkencor:**

**Prof. Asc. Dr. Alketa Hoxha(Qosja)**

**TIRANË 2023**  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË**  
**FAKULTETI I MJEKËSISË**



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

**PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE**

**DOKTOR**

**SPECIALITETI: ANATOMI PATOLOGJIKE**

**TEMA: “STUDIM KLINIK-MORFOLOGJIK I TUMOREVE TË TRURIT  
NË MOSHËN PEDIATRIKE”**

**MBROHET NË DATË: 26/07/2023 PARA JURISË:**

1. Prof. Asc. Arben Lloja.....KRYETAR
2. .Prof. Mehdi Alimehmeti.....ANËTAR (OPONENT)
3. Prof. Asc. Leart Berdica.....ANËTAR (OPONENT)
4. Prof. Elmira Kola.....ANËTAR
5. Prof. Asc. Donjeta Bali.....ANËTAR

## **Shkurtime**

CT	Tomografi e kompjuterizuar
MRI	Rrezonance magnetike
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
HGG	Gliomat me gradë të lartë
LGG	Gliomat me gradë të ulët
SNQ	Sistemi Nervor Qendror
ATRT	Tumoret atipike teratoid rabdoide
OTG	Gioma e traktit optik
DNET	Tumori neuronal disembrioplastik
PNET	Primitive Neuro-Ectodermal Tumors
ETANTR	Tumor embrional me neuropil të bollshëm dhe rozeta të vërteta

## Përmbajtja

I HYRJE.....	11
1.1 Tumoret e trurit në moshën pediatrike .....	11
1.1 Shenjat klinike.....	12
1.2 Lloji .....	12
1.3 Topografia .....	12
1.4 Varietetet histologjike .....	14
1.5 Analiza gjenetike dhe molekulare .....	14
1.6 Tumoret e trurit specifike të fëmijërisë .....	15
1.8 Prognoza dhe trajtimi .....	15
1.9 Strategjia e imazherisë .....	15
1.9.1 CT cerebrale .....	16
1.9.2 MR cerebrale .....	16
1.9.3 MR konvencionale.....	17
1.9.4 MR diffusion weighted.....	19
1.9.5 MRI me Perfuzion .....	19
1.9.6 MR Spektroskopia .....	19
2.0 Gliomat.....	20
2.1 Astrocitoma pilocitare.....	20
2.2 Glioma të tjera.....	21
2.3 Glioma anaplastike (astrocitoma, oligoastrocitoma).....	21
2.4 Glioblastomat (grada 4).....	21
2.5 Oligodendrogliomat .....	22
2.6 Glioma angiocentrike .....	22
2.7 Astrocitoma me qeliza gjigante.....	22
2.8 Glioma e trungut të trurit.....	23
2.9 Glioma difuze intrinseke pontine .....	23
2.10 Tumori neuronal disembrioplastik (DNET).....	23
2.11 Tumori glioneuronal i diseminuar.....	24
3.0 Tumoret embrionale .....	24

3.1 Meduloblastoma .....	24
4.0 Tumori rhabdoid.....	25
5.0 Tumoret PNET të sistemit nervor qendror (SNQ). .....	25
6.0 Ependimoma.....	26
7.0 Tumoret e qelizave embrionale .....	26
7.1 Germinoma.....	26
7.2 Tumoret e qelizave germinale jo germinomatoze .....	27
8.0 Teratomat .....	27
9.0 Tumoret pineale.....	28
9.1 Pineoblastoma .....	28
9.2 Tumori i gjëndrës pineale papilare.....	28
10.0 Tumoret supraselare .....	28
11.0 Kraniofaringioma .....	28
12.0 Hamartoma hipotalamike .....	29
13.0 Tumoret e pleksit koroid .....	29
II METODOLOGJIA.....	32
2.1 Qëllimi.....	32
2.2 Objektivat .....	32
2.3 Materiali dhe Metoda .....	32
2.4 Metodologjia e analizës statistikore .....	34
III REZULTATE .....	36
IV DISKUTIM.....	60
V PËRFUNDIME .....	65
VI REKOMANDIME.....	66
VII SHTOJCA .....	67
VII BIBLIOGRAFIA.....	68

## Lista e tabelave

Tabela 3. 1 Karakteristikat demografike të pacientëve.....	36
Tabela 3. 2 Lloji dhe frekuenca e shenjave dhe simptomave .....	39
Tabela 3. 3 Lokalizimi i tumoreve të trurit .....	43
Tabela 3. 4 Lokalizimi supra dhe infratentorial.....	43
Tabela 3. 5 Lokalizimi i tumorit sipas gjinisë dhe grupmoshës .....	44
Tabela 3. 6 Kohëzgjatja mediane e simptomave para diagnostikimit .....	46
Tabela 3. 7 Tipi histopatologjik i tumoreve.....	47
Tabela 3. 8 Tipi histopatologjik i tumoreve sipas grupmoshës .....	51
Tabela 3. 9 Përhapja e sëmundjes .....	52
Tabela 3. 10 Trajtimi i sëmundjes.....	53
Tabela 3. 11 Frekuenca e exitus sipas karakteristikave sociodemografike dhe klinike....	55
Tabela 3. 12 Faktorët parashikues të exitus– Modeli i regresionit Cox.....	58

## Lista e figurave

Figura 3. 1 Shpërndarja e rasteve sipas gjinisë .....	37
Figura 3. 2 Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshës .....	37
Figura 3. 3 Frekuenca e sëmundjes gjenetike hereditare .....	38
Figura 3. 4 Lloji dhe frekuenca e shenjave dhe simptomave.....	40
Figura 3. 5 Manifestimet e presionit intrakranial të rritur .....	40
Figura 3. 6 Lloji i deficiteve neurologjike .....	41
Figura 3. 7 Forma e konvulsioneve.....	42
Figura 3. 8 Çrregullimet hormonale.....	42
Figura 3. 9 Lokalizimi i tumoreve të trurit .....	43
Figura 3. 10 Lokalizimi supra dhe infratentorial .....	44
Figura 3. 11 Lokalizimi i tumorit sipas gjinisë.....	45
Figura 3. 12 Lokalizimi i tumorit sipas grupmoshës .....	45
Figura 3. 13 Figura 3. 14 Kohëzgjatja mediane e simptomave para diagnostikimit .....	46

Figura 3. 15 Tipi histopatologjik i tumoreve .....	48
Figura 3. 16 Lloji i tumoreve embrionale .....	48
Figura 3. 17 Gliomat e gradës së ulët .....	49
Figura 3. 18 Glioma të gradës së lartë .....	50
Figura 3. 19 Ependimomat.....	50
Figura 3. 20 Tumore të qelizave germinale .....	50
Figura 3. 21 Tipet e tjera.....	51
Figura 3. 22 Tipi histopatologjik i tumoreve sipas grupmoshës.....	52
Figura 3. 23 Përhapja e sëmundjes .....	53
Figura 3. 24 Trajtimi i sëmundjes .....	54
Figura 3. 25 Frekuenca e exitus sipas gjinisë .....	56
Figura 3. 26 Frekuenca e exitus sipas grupmoshës.....	56
Figura 3. 27 Frekuenca e exitus sipas lokalizimit.....	57
Figura 3. 28 Frekuenca e exitus sipas tipit histologjik.....	57
Figura 3. 29 Faktorët parashikues të exitus– Modeli i regresionit Cox.....	58

## ***Parathenie***

*Ekziston një gamë shumë e gjerë histologjike e tumoreve të trurit te fëmijët, megjithëse më të zakonshmet janë medulloblastomat, astrocitomat dhe ependimomat.*

*Ekzaminimi i vendit të lezionit dhe paraqitjes së tij në CT dhe MR mund të sigurojë një diagnozë para interventit kirurgjikal, sa i përket llojit dhe gradës në shumicën e rasteve. Klasifikimi histologjik i tumoreve ka evoluar vazhdimisht që nga krijimi i tij. Klasifikimet e ardhshme do të përfshijnë gjetjet gjenetike dhe molekulare, duke dalluar nëntipet e lidhura me prognoza të ndryshme, me trajtime individuale më të targetuara. Imazheria, veçanërisht duke përdorur teknika të avancuara, do të ketë një rol të rëndësishëm për të provuar dhe identifikuar biomarkerët e rinj, të cilët lidhen me këto nëntipe biologjike.*



## **Falenderime**

Për realizimin e kësaj teme diplome një falenderim i veçantë shkon për udhëheqësin tim Prof. Asc. Dr. Alketa Qosja (Hoxha) për mbështetjen, përkrahjen dhe këshillat e tij në të gjitha etapat e studimit.

Gjithashtu falenderoj familjen time dhe koleget për ndihmën, mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm që më kanë dhënë deri në finalizimin me sukses të këtij projekti shkencor.

## Abstrakt

**Hyrje:** Tumoret e trurit janë tumoret më të zakonshme (20-22%) tek fëmijët pas leuçemive (30%), megjithëse ato janë ende shkaku kryesor i vdekjeve nga kanceri dhe kanë një sërë karakteristikash specifike në krahasim me të rriturit. Përcaktimi i karakteristikave klinike dhe morfologjike të tumoreve intrakraniale tek fëmijët.

**Materiali dhe metoda:** Ky është një studim observacional prospektiv i kryer në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në Tiranë gjatë viteve 2010-2015. Në studim janë përfshirë 67 pacientë me tumore malinje të trurit. Kriteret e përfshirjes ishin diagnoza e një tumori primar të trurit dhe pacientët e moshës 0-14 vjeç në kohën e diagnozës. Nëpërmjet një skede klinike u mblodhën dhe u analizuan në studim variablat demografike dhe klinike.

**Rezultate:** Nga shenjat dhe simptomat mbiotërojnë: presion intracranial i rritur në (74.6%) të pacienteve, deficite neurologjike në (61.2%), Konvulsione epileptike (19.4%) dhe çrregullime hormonale në (10.4%) të pacientëve ( $p < 0.01$ ). Në lidhje me tipin histopatologjik u evidentuan: tumore embrionale (19.4%), glioma të gradës së ulët (53.7%), glioma të gradës së lartë (11.9%), ependymoma (9%), tumore të qelizave germinale (3%), dhe tjetër (3%), me mbizotërim të gliomave me gradë të ulët me ndryshim sinjifikant me tipet e tjera ( $p < 0.01$ ). Në exitus përfunduan 17 (25.4%) e pacientëve (95%CI 15.5 – 37.5). Faktorë sinjifikante të riskut për exitus rezultuan: Deficite neurologjike ( $p < 0.01$ ), Çrregullime hormonale ( $p < 0.01$ ), Lokalizimi supratentorial ( $p < 0.01$ ), Shkalla e përhapjes së sëmundjes ( $p < 0.01$ ).

**Përfundim:** Menaxhimi multidisiplinar në fillim të trajtimit siguron trajtim të menjëhershëm dhe të përshtatshëm sipas protokolleve ekzistuese të disponueshme për shumicën e entiteteve tumorale.

**Fjalë kyç:** fëmijë, tumore, klinike, morfologji

## **I HYRJE**

### **1.1 Tumoret e trurit në moshën pediatrike**

Tumoret e trurit janë tumoret më të zakonshme (20-22%) tek fëmijët pas leuçemive (30%), megjithëse ato janë ende shkaku kryesor i vdekjeve nga kanceri dhe kanë një sërë karakteristikash specifike në krahasim me të rriturit (1).

Tumoret cerebrale mund të gjenden shpesh tek fëmijët dhe mund të jenë beninje dhe malinje. Pas leuçemisë, tumori i trurit është lloji i dytë më i zakonshëm i kancerit tek të gjithë fëmijët në mbarë botën. Në mënyrë tipike, tumoret e trurit tek fëmijët lindin nga inde të ndryshme nga ato që prekin të rriturit. Tumoret e fosës së pasme janë të shpeshta, pothuajse po aq sa ato supratentoriale, megjithëse varen edhe nga mosha. Tumoret supratentoriale janë më të shpeshta tek fëmijët më të vegjël se 3 vjeç, ndërsa tumoret e fosës së pasme mbizotërojnë te fëmijët 3 deri në 11 vjeç. Pas kësaj moshe, incidenca e këtyre tumoreve supra dhe infra tentoriale është e njëjtë. Sipas klasifikimit të OBSH-së të vitit 2007, tumoret klasifikohen sipas llojit dhe shkallës histologjike (shkalla e malinjitetit). Tumoret beninje janë të shkallës 1 dhe 2, ndërsa grada 3 dhe 4 janë tumore malinje. Tek fëmijët vërehet një heterogjenitet i theksuar i llojeve histologjike, si në tumoret malinje ashtu edhe ato beninje. Në 80% të rasteve hasen tumore primare neuroepiteliale, ndërsa 3-5% janë kraniofaringeoma dhe tumore të qelizave germinale (2).

Më të zakonshmet nga tumoret neuroepiteliale janë gliomat (30 - 50%), veçanërisht astrocitoma pilocitike (20% e tumoreve primare neuroepiteliale), e ndjekur në rend zbritës nga tumoret glioneuronal neuronal dhe të përzier, të cilët përbëjnë afërsisht 19% tumore embrionale, të cilat përbëjnë për 17% dhe ependimomat që përbëjnë afërsisht 11%. Trajtimi mund të jetë kirurgjik, radiokirurgjik, radioterapeutik ose kimioterapeutik. Jo rrallë mund të jetë i nevojshëm një kombinim i modaliteteve të ndryshme, i cili kryhet në bashkëpunim me kolegë nga shërbime të tjera si: neuropediatri, neuroimazheri, kirurgjia foshnjore, reparti i terapisë intensive pediatrike, onkohematologjia. Kohët e fundit teknikat kirurgjikale, mjetet në sallën e operacionit dhe teknikat e anestezisë janë përmirësuar, duke i bërë ndërhyrjet më të sigurta. Gjithashtu, modalitetet plotësuese (radioterapia /kimioterapia) kanë avancuar (3).

Neoplazitë neurologjike përbëjnë shumicën e tumoreve solide tek fëmijët dhe janë shkaku kryesor i vdekjeve të lidhura me malinje. Në dekadat e fundit, përparimet në gjenetikë dhe biologji molekulare kanë çuar në përmirësime në metodat e diagnostikimit dhe trajtimit në neuro-onkologjinë pediatrike në mbarë botën. Klasifikimi i fundit i

OBSH-së i tumoreve të SNQ ka përmirësuar gjithashtu kriteret për diagnozën. Tumoret e trurit janë tumoret solide më të zakonshme tek fëmijët dhe shoqërohen me vdekshmëri të lartë. Tumoret më të zakonshme të trurit të fëmijërisë grupohen si glioma të shkallës së ulët (LGG), glioma të shkallës së lartë (HGG), ependimoma dhe tumore embrionale, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Përparimet në gjenetikën molekulare kanë çuar në një zhvendosje nga diagnoza e pastër histopatologjike në diagnozën e integruar. Diagnoza e integruar bazohet në ngjashmëritë gjenomike molekulare të nënklasave të tumorit dhe mund të shpjegojë më mirë ndryshimet në kurset klinike të entiteteve të mëparshme histopatologjike identike. Përparime të rëndësishme janë bërë edhe në neuro-onkologjinë pediatrike. Një kuptim në rritje i sfondit molekular-gjenetik të tumorigenezës ka përmirësuar saktësinë diagnostike (4).

Ristratifikimi i protokolleve të trajtimit dhe zhvillimi i terapive të synuara do të ndikojnë ndjeshëm në mbijetesën e përgjithshme dhe cilësinë e jetës.

Për disa tumore pediatrike, këto përparime kanë përmirësuar ndjeshëm menaxhimin terapeutik dhe prognozën në nëngrupe të caktuara të tumorit.

Disa qasje terapeutike gjithashtu kanë pasoja serioze afatgjata. Prandaj, nevojiten shumë trajtime të optimizuara me një bashkëpunim multidisiplinar.

### **1.1 Shenjat klinike**

Shenjat klinike janë të shumta dhe jo specifike dhe varen nga lokalizimi i tumorit dhe moshja e fëmijës. Këto përfshijnë shenja të rritjes së presionit intrakranial (RICP) dhe shenja të ndryshme neurologjike (epilepsi, çrregullime vizuale dhe endokrine, ataksi dhe paraliza e nervave kraniale). Shenjat janë më mashtruese tek fëmijët e vegjël (makrocefalia, fryrja e fontaneleve, vështirësitë në të ushqyer, pamundësia për të fituar aftësi të reja, hypotonia dhe axhitimi) (5).

### **1.2 Lloji**

Ndryshe nga të rriturit, metastazat janë shumë të rralla tek fëmijët. Tumoret e trurit janë pothuajse pa ndryshim primare dhe tumoret ekstra-aksiale janë jashtëzakonisht të rrallë dhe janë të predispozuar ndaj ndryshimeve gjenetike si NF2.

### **1.3 Topografia**

Tumoret e fosës posteriore janë po aq të zakonshme në përgjithësi sa tumoret supratentoriale, megjithëse kjo ndryshon në varësi të moshës. Në moshën nën 3 vjeç, mbizotërojnë tumoret supratentoriale, ndërsa tumoret e fosës posterior janë më të zakonshme midis moshës 3 dhe 11 vjeç. Më pas, incidenca e tumoreve supra- dhe infratentoriale është identike (6). Tumoret lokalizohen në linjën e mesme në 85% të rasteve, në fossa posterior në 50%, në regjionin suprasellar në 30% dhe në rajonin pineal

në 5%. Ky është një faktor rreziku për përhapjen meningeale dhe kërkon një MR plotësuese të shtyllës kurrizore së bashku me MR cerebrale para trajtimit me një sekuencë sagitale T1-weighted pas injektimit të gadoliniumit. Tumoret hemisferike përbëjnë afërsisht 15% të tumoreve dhe shpesh shkaktajnë epilepsi. Lokalizimi ofron një lloj udhëzimi për llojin e tumorit (Tabela 1). Tumoret e fossa posterior përfshijnë astrocitomën pilocitike, glioma të trungut të trurit, medulloblastoma dhe endimoma. Gliomat malinje duhet të merren parasysh në rastin e tumoreve në ganglionet bazale dhe talamus. Gliomat malinje gjithashtu duhet të merren parasysh në hemisferat e thella, ndërsa, në periferi, tumoret janë zakonisht benignë, siç është DNET (7).

Tabela 1 Histologjia e tumoreve të trurit sipas lokalizimit

Lokalizimi	Lokalizimi	Tipi
Fossa posterior	Cerebelum/Vermis/V4	Astrocitoma pilocitike
		Medulloblastoma
		Ependimoma
		Tumori rhabdoid (ATRT)
	Trungu i trurit	Glioma infiltrative
		Glioma e kufizuar
Hemisferat	Sipërfaqesor	Ganglioglioma
		DNET
		Ksantoastrocitoma pleiomorfike
		Glioma angiocentrike
		Oligodendroglioma
	Të thellë	Tumor embrionik
		Glioma malinje
		Ependimoma
		Glioma malinje
		Germinoma
Berthama e lendes gri		
Intraventriculare		Papiloma e plexit koroid
		Astrocitoma subependimale me qeliza gjigande
Supraselare		Kraniofaringeoma
		Glioma e traktit optik
		Germinoma
		Hamartoma hipotalamike
Pineale		Germinoma
		Pineoblastoma
		Tumor papilar i gjendrës

		pineale
ATRT: tumor rhabdoid teratoid atipik ; DNET: tumor neuronal disembrionoplastik; V4: ventrikuli 4		

#### 1.4 Varietetet histologjike

Tumoret klasifikohen sipas llojit dhe shkallës së tyre histologjike (niveli i malinjitetit) në klasifikimin e WHO 2007(8). Klasat 1 dhe 2 janë tumore beninje dhe klasat 3 dhe 4 janë malinje. Ka heterogjenitet të konsiderueshëm në llojet histologjike tek fëmijët, si në tumoret beninje ashtu edhe malinje. Tumoret primare neuroepiteliale janë më të zakonshmet (80%), të ndjekur nga kraniofaringiomat dhe tumoret e qelizave germinale (3-5%). Më të zakonshmet nga tumoret neuroepiteliale janë gliomat (30-50%), veçanërisht astrocitoma pilocitike (20% e tumoreve primare neuroepiteliale), e ndjekur në rend zbritës nga tumoret glioneuronale neuronale dhe të përzier, të cilët përbëjnë afërsisht 19% (ganglioglioma, DNET, gangliocitoma, gangliocitoma cerebellare displastike), tumoret embrionale, të cilat përbëjnë 17% (medulloblastoma, tumoret rhabdoide ose ATRT, tumoret primare neuroepidermale ose SNQ PNET), dhe endimomat që përbëjnë afërsisht 11%. Astrocitomat pilocitare, medulloblastomat, gliomat e tjera dhe endimomat përbëjnë mbi 80% të tumoreve të fëmijërisë (9). Glioblastoma është 100 herë më pak e zakonshme se tek të rriturit. Incidenca e këtyre llojeve të ndryshme histologjike varet nga mosha. Nën 3 muajsh, mbizotërojnë teratomat (30-50%), astrocitomat pilocitare (18-47%), papillomat (5-20%) dhe tumoret embrionale [4,5]. Medulloblastoma është tumori mbizotërues midis moshës 0 dhe 4 vjeç, astrocitoma pilocitike midis 5 dhe 9 vjeç, glioma e shkallës së lartë midis 10 dhe 14 vjeç dhe tumoret supraselare midis 5 dhe 19 vjeç (10).

#### 1.5 Analiza gjenetike dhe molekulare

Kjo kryhet si një proces plotësues i ekzaminimit histologjik dhe siguron një vlerësim më të mirë të diagnozës/prognozës dhe përgjigjes ndaj trajtimit. Gliomat e fëmijërisë kanë karakteristika të ndryshme molekulare dhe gjenetike me ato të të rriturve dhe i njëjti lloj histologjik mund të ketë karakteristika të ndryshme histomolekulare në varësi të vendndodhjes së saj (11).

Aspekte të reja nga OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) 2007.

Këto përmbajnë shtesa dhe përkufizime ose sqarime të reja të sëmundjeve ekzistuese. Disa grupe tumoresh janë të përqëndruara në popullatën pediatrike (12). Për gliomat, këto përfshijnë dy lloje të tumorit, astrocitoma pilomiksoide dhe glioma angiocentrike. Astrocitoma pilomiksoide (grada 2), e cila është një variant i astrocitomës pilocitike, karakterizohet nga rekurenca dhe diseminimi lokal. Glioma angiocentrike (shkalla 1, e njohur gjithashtu si tumor neuroepitelial angiocentrik) shihet tek fëmijët dhe të rinjtë me epilepsi rezistente ndaj medikamenteve. Diagnoza zakonisht vendoset në ekzaminimin

histologjik. Nga tumoret intraventriculare, papilloma atipike e pleksusit koroid (grada 2) karakterizohet me rritje të aktivitetit mitotik, i cili nuk diferencohet apo dallohet nga papilloma në imazheri dhe diagnoza është histologjike (13). E njëjta gjë vlen edhe për tumoret glioneuronale hemisferike të tumoret glioneuronale papilare (PGNT), të cilat në përgjithësi diagnostikohen si ganglioglioma para operacionit. Në regjionin pineal, tumori papilar nuk ka veçori specifike imazherike dhe diagnoza është gjithashtu histologjike. Midis tumoreve embrionale, medulloblastoma me nodularitet të gjerë mund të duket në imazheri e ngjashme me një medulloblastomë klasike. Megjithatë, është karakteristike një pamje e veshit të rrushit me noduse të shumta të zgjeruara. Ekzistojnë predispozita të forta gjenetike për këtë tumor, duke përfshirë sindromën Fragile X dhe sindromat Li-Fraumeni dhe Gorlin. Një koncept i ri i tumorit embrional me neuropil të bollshëm dhe rozeta të vërteta (ETANTR, klasa 4) përshkruhet midis PNET-ve të tjera. Ky është një tumor i hemisferës me pak ose aspak edemë peritumorale dhe rritje të dobët ose jo-ekzistente (14).

### **1.6 Tumoret e trurit specifike të fëmijërisë**

Tek foshnjat, këto janë ganglioglioma infantile desmoplastike (grada 1) dhe tumori atipik rhabdoid (ATRT) (grada 4), të cilat mbartin një prognozë të dobët, papilloma të pleksit koroid (grada 1) dhe teratoma. Pavarësisht moshës, tumoret e tjera që janë unike për popullatën pediatrike janë astrocitoma pilocitare dhe tumoret e qelizave germinale sekretore ose jo sekretore.

#### **1.7 Konteksti sindromik**

Herë pas here, tumore specifike të trurit mund të shfaqen në sindromat predispozuese për kancer: NF1 (glioma e traktit optik), NF2 (meningioma, ependimoma), skleroza tuberoze (tumori subependimal me qeliza gjigante) dhe sindroma Gorlin ose Li-Fraumeni (medulloblastoma) (15).

### **1.8 Prognoza dhe trajtimi**

Këto varen nga shkalla dhe lloji histologjik dhe nga vlerësimi i stadi, por edhe nga moshja e fëmijës. Tumoret tek fëmijët nën 6 muajsh kanë një prognozë të dobët për shkak të incidencës më të lartë të malinjitetit, madhësisë më të madhe të tumorit dhe kundërrindacionit ndaj radioterapisë për shkak të efekteve negative në trurin në zhvillim.

### **1.9 Strategjia e imazherisë**

Prognoza dhe trajtimi i tumoreve të trurit varet nga grada histologjike, e cila bazohet në kriteret e WHO 2007, të marra pas biopsisë ose rezeksionit kirurgjikal. Në përgjithësi, trajtimi gjithmonë fillon me kirurgji, mundësisht të plotësuar me kimioterapi dhe/ose

radioterapi në varësi të llojit histologjik dhe shkallës së tumorit. Megjithatë, është e rëndësishme të merret një diagnozë e saktë para operacionit për llojin e tumorit të dyshuar për disa arsye. Së pari është thelbësore të bëhet dallimi midis tumoreve të vërteta dhe pseudotumoreve (abscese, leziona demielinizuese, encefalit, etj.), të cilët mund të kenë të njëjtën paraqitje klinike dhe nuk duhet të trajtohen me rrugë kirurgjikale. Prandaj, kjo kërkon MRI shumë parametrike (16). Njohja e llojit dhe gradës së tumorit mundëson planifikimin e operacionit (qasja kirurgjikale) ose orientimin e biopsive drejt pjesëve më malinje të lezionit. Në një tumor të dyshuar benign, operacioni mund të jetë më pak agresiv në disa zona. Kjo duket të jetë thelbësore për të ruajtur rezultatin e ardhshëm neurologjik të fëmijës. Përveç kësaj, disa tumore nuk trajtohen me rrugë kirurgjikale dhe herë pas here nuk realizohet biopsi për shkak të vendndodhjes së tyre (trakti optik, trungu i trurit) dhe diagnoza dhe zgjedhja e trajtimit bazohet në imazhe. Qasja diagnostike përfshin analizën e vendit të tumorit dhe pamjet e tij në MR dhe CT, duke përfshirë faktorët që lidhen me gjetjet klinike dhe moshën e pacientit (17).

### **1.9.1 CT cerebrale**

Për shkak të disponueshmërisë dhe shpejtësisë së tij, CT është ekzaminimi i parë që kryhet për një tumor të dyshuar të trurit. Ai siguron një diagnozë pozitive të tumorit dhe tregon nëse ka shenja të hernimit të trurit, të cilat përcaktojnë urgjencën e operacionit. Kjo kryhet në mënyrë të pazgjeruar për të identifikuar hemorragjinë ose kalcifikimet, e ndjekur nga shtimi i kontrastit. Këto karakteristika janë të vështira për t'u dalluar në MRI [12] edhe duke përdorur imazhe në sekuencat T2\* -weighted me gradient eco dhe SWI. CT mund të përdoret gjithashtu për të vlerësuar qelizën tumorale, një tumor hiperdens në CT reflekton hiper celularitet dhe shumë shpesh një gradë të lartë (18).

### **1.9.2 MR cerebrale**

MR është ekzaminimi i zgjedhur për vlerësimin preoperator të një tumori të trurit të fëmijëve. Ai përfshin imazhe konvencionale multiplanare dhe teknika të avancuara, të cilat duhet të jenë pjesë e vlerësimit fillestar të çdo tumori të trurit. Imazhet T1 dhe T2 weighted dhe imazhet T1 me shtim të gadoliniumit ofrojnë një vlerësim morfologjik dhe stadifikues të lezionit, por megjithatë duket se janë të kufizuara në aftësinë e tyre për të ofruar një karakterizim më të detajuar, veçanërisht për sa i përket llojit dhe shkallës histologjike. Teknikat e avancuara të MR si imazhet me diffusion-weighted, MR spektroskopia dhe MR me perfuzion ofrojnë një qasje funksionale që përmirëson karakterizimin e qelizës, hemodinamikën vasculare dhe metabolizmin e indeve, duke përmirësuar specifikën e MR.



### 1.9.3 MR konvencionale

Protokolli i imazherisë duhet të përshtatet për të marrë parasysh vendndodhjen e tumorit. Kjo duhet të përfshijë një minimum imazhesh T1-weighted pa gadolinium, imazhe T2 weighted dhe T2\* dhe FLAIR, imazhe të volumit 3D ose të paktën plane ortogonale 2× T1weighted pas nxitjes së gadoliniumit (19). Interpretimi duhet të përfshijë një analizë të kufijve të lezionit (infiltrues ose ekspansiv), regjistrimin e vendit të tij, nëse është unifokal apo multifokal, madhësia dhe intensiteti i tij në imazhet T1, T2 dhe FLAIR, nëse është homogjen apo heterogjen në pamje dhe nëse ka nekrozë ose kiste brenda tumorit, vasat e gjakut makroskopikisht jonormale, shtim të kontrastit, edemë rreth tumorit, një efekt hapësirzënës ose zona meningeale të sëmundjes. Pamja e përgjithshme e lezionit mund të ketë tipare karakteristike në një vend të përcaktuar qartë (një astrocitomë pilocitare në fosën posterior, teratoma, kraniofaringioma, etj.) (tabela 2). Jashtë këtyre kushteve, kërkohen prova për të mbështetur natyrën beninje ose malinje të lezionit, i cili gjithashtu varet nga vendi i tumorit:

- një tumor hemorragjik me edemë periferike që përmban enë të shumta ektatike sugjeron për një tumor malinj, megjithëse, në një studim të fundit, edema rreth tumorit dhe një efekt mase nuk lidhej me tumor te gradës së lartë tek fëmijët, pasi edema rreth tumorit ishte më e pranishme. në tumoret beninje (50%) sesa malinje (31%) (20).;
- në imazhet me peshë T2 (T2WI), tumoret hiperqelizore (shpesh me gradë të lartë) janë iso-/hipointense në krahasim me korteksin, ndërsa tumoret pauciqelizore (shpesh me gradë të ulët) janë hiperintense (21). Në këtë sekuencë shihet qartë edhe mikrovaskulatura e tumorit;
- Niveli i shtimit të kontrastit nuk lidhet me shkallën e tumorit tek fëmijët. Astrocitoma pilocitike dhe papilloma e pleksusit koroid rriten intensivisht pas injektimit të gadoliniumit, ndërsa këto janë tumore të shkallës së ulët. Në të kundërt, tumoret e shkallës së lartë si astrocitoma anaplastike, medulloblastoma ose ETANTR, mund ose nuk mund të rriten;
- Kistet intra dhe peritumorale të cilat janë izointense me LCS (likidi cerebrospinal) janë karakteristike konvencionale për astrocitomat pilocitare, ganglioglioma (pavarësisht gradës) dhe DNET (në të cilat në përgjithësi kistet intratumorale janë më pak se 5 mm në madhësi);
- nekroza, e cila nuk është izointense me LCS, e parë zakonisht në imazhet FLAIR, është më e rrallë se tek të rriturit, pasi tumoret priren të jenë më tepër hiperqelizore sesa nekrotike. Megjithatë, tumoret embrionale dhe ependimomat e fosës posterior shpesh janë nekrotike. Nekroza, megjithatë, mund të jetë e pranishme në tumoret beninje

(astrocitoma pilocitare) dhe të mungojë plotësisht në tumoret hipercelulare të shkallës së lartë (22).

**Tabela 2 Karakteristikat imazherike të tumoreve më të hasura te fëmijët**

Tumor i fossa posterior	
○ Meduloblastoma	ADC e ulët
○ Astrocitoma pilocitike	Kist me mure që nxiten nga kontrasti; ADC e lartë
○ Ependimoma	Përhapje drejt foramen Luschka dhe Magendie
Tumore supraselare	
○ Kraniofaringioma	Kist hiperintens ne T1W1, i kalcifikuar
○ Germinoma	pjesa solide hipointense në T2 dhe ADC ≤ trurit normal.
○ Astrocitoma pilocitike	Kolina e lartë dhe ADC në pjesët indore
Tumoret pineale	
○ Germinoma	Pjesa solide hypointense në T2W1 dhe ADC ≤ trurit normal.
○ Teratoma	Kiste, kalcifikime në përbërësit indore
○ Pineoblastoma	ADC shumë e ulët
Tumoret kortikale	
○ Gangliogioma	Kalcifikime
○ DNET	Pseudokistike dhe kistike
○ Ksantastrocitoma pleiomorfike	Nxitje sipërfaqësore dhe meningeale
○ Glioma angiocentrike	Unaze hyperintense ne T1W1
Tumore intraventriculare	
○ Papiloma e pleksit koroid	Nxitje intense në trigonumin ventrikular
○ Astrocitoma subependimale me qeliza gjigande	Foramen Monro, skleroza tuberoze
Tumoret DGN	
○ Gliomat, germinomat	
Tumoret hemisferike	
○ Gliomat, PNET	ADC e ulët, nekroze dhe hemorragji
○ Ependimomat	Intraparenkimale, ngjitur me trigonum ventrikular
DNET: Dysembryoplastic neuronal tumor; PNET: tumor primar neuroektodermal; DGN: Bërthamat gri të thella; WI:weighted imaging	

#### **1.9.4 MR diffusion weighted**

Imazhet ne difuzion duhet të përdoren në mënyrë rutine pasi kjo është e ndjeshme ndaj qelizës së tumorit. ADC është në përpjesëtim të zhdrejtë me densitetin e qelizave dhe për këtë arsye gradën e tumorit (23). Të gjithë tumoret embrionale (meduloblastoma, tumori rhabdoid dhe PNET) dhe pineoblastoma dhe tumoret e qelizave embrionale, kryesisht te fëmijët, janë malinje (grada 4) dhe kanë një ADC shumë të ulët. Prandaj, imazhet në diffusion weighted dallojnë tumoret e gradës së lartë nga ato të ulëta tek fëmijët në mungesë të hemorragjisë, si në nivel supra- dhe infratentorial dhe nuk ka vlerë kufitare midis gradëve ose midis tumoreve kryesore. Të gjithë tumoret të kombinuara, DNET ka vlerën më të lartë dhe tumoret embrionale kanë vlerën më të ulët (24).

#### **1.9.5 MRI me Perfuzion**

MRI me perfuzion me kontrast dinamik T2\*-weighted reflekton në mënyrë indirekte densitetin dhe përhapjen vaskulare brenda tumorit nga matja e rCBV (vëllimi relativ i gjakut cerebral). RCBV lidhet me shkallën e tumorit glial tek të rriturit, tumoret e gradës së lartë që kanë një rCBV më të lartë se tumoret e shkallës së ulët. Këto gjetje ndoshta nuk mund të ekstrapolohen tek fëmijët për shkak të dallimeve histologjike midis tumoreve. Ka pak studime të MRI me perfuzion mbi tumoret cerebrale në popullata specifike pediatrike, ndoshta për shkak të problemeve teknike të injektimit. Sidoqoftë, është plotësisht e mundur të kryhet një MR me perfuzion tek fëmijët e vegjël duke përdorur kateterë të vegjël dhe shpejtësi injeksionesh prej 0,8 deri në 1 ml/s, ose duke përdorur injeksion manual (25). Një teknikë alternative e MR me perfuzion (etiketimi i spinit arterial) raportohet se dallon tumoret e trurit të shkallës së lartë nga ato të ulëta tek fëmijët, por jo llojet e ndryshme histologjike. RTBF maksimale (rrjedhja relative e gjakut të tumorit) është më e lartë në tumoret me gradë të lartë krahasuar me tumoret e gradës së ulët (26).

#### **1.9.6 MR Spektroskopia**

Spektroskopia MR (MRS) përdoret për të studiuar metabolizmin e tumorit. Karakteristikat kryesore të tumoreve malinje janë nivelet e larta të kolinës (Cho), që i atribuohen proliferimit të membranës qelizore dhe niveleve të reduktuara të N-acetilaspartinatit (NAA) dhe kreatinës (Cr) që i atribuohen edemës dhe nekrozës (27). Një sinjal laktat (Lac) shihet shpesh në leziona malinje dhe jo të shkallës së ulët, për shkak të acidozës metabolike brenda indit tumoral. Nekroza reflektohet nga një rritje e rezonancës Lac/Lip (lipid) e shoqëruar me një rënie të të gjithë metabolitëve të tjerë. Raportet më të larta të Cho/Cr dhe Cho/NAA shihen në tumoret agresive dhe gliomat difuze të trungut të

trurit. Shihen disa tipare spektroskopike të tumoreve të ndryshme të trurit pediatrikë. Astrocitoma pilocitike beninje ka një nivel të lartë Lac si rezultat i metabolizmit biokimik ende të pakuptuar. Raportet Cho/NAA dhe Cho/Cr janë rritur pavarësisht nga fakti se këto leziona janë beninje. Prandaj, te fëmijët, kolina e rritur nuk është sinonim i një tumori malinj. Në neurofibromatozën e tipit 1, raporti Cho/Cr ndihmon për të dalluar përfshirjen lokale intraparenkimale, e cila është hiperintense në imazhin T2, nga tumoret gliale dhe parenkimën e shëndetshme (28) tek fëmijët. Glioblastomat kanë përqendrimet më të larta të glutamine-glutamatit të alaninës dhe glicinës. Nivelet e mioinozitolit janë treguar të jenë të rritura në papilomën e pleksit koroid. Ky është një lezion beninj, veçanërisht në krahasim me karcinomën malinje të pleksit koroid, në të cilin kolina është e rritur. Mioinositoli rritet gjithashtu në endimoma. Përqendrimet e taurinës rriten në tumoret neuroektodermale primare (PNET) dhe citrati gjendet në astrocitomat pontine infiltrative malinje. Tumoret e qelizave embrionale kanë nivele të larta të glutamine - glutamatit. E marrë vecmas, çdo teknikë duket të jetë e kufizuar në dallimin dhe klasifikimin e tumoreve. Prandaj, një qasje multimodale me MR duket të jetë thelbësore në vlerësimin para operacionit të një tumori në mënyrë që të përmirësohet karakterizimi i tij. Ndryshe nga të rriturit, pak studime të mëdha pediatrike janë të disponueshme pasi këto tumore janë më pak të zakonshme dhe janë histologjikisht më të larmishëm (29).

## **2.0 Gliomat**

### **2.1 Astrocitoma pilocitare**

Ky është tumori më i zakonshëm tek fëmijët dhe përbën 30% të tumoreve të fosës posterior. Është një tumor beninj (grada 1), e rrethuar qartë dhe me rritje të ngadaltë, shpesh tumor i vogël, i gjetur midis moshës 5 dhe 13 vjeç. Kirurgjia është kurative pa rekurenca nëse hiqet plotësisht. Gjashtëdhjetë deri në 80% e astrocitomave pilocitare ndodhen në cerebelum, zakonisht në hemisferat cerebelare ose në vermis. Vendet e tjera të përfshira janë rajoni hipotalamo-hipofizar, talamusi, trangu i trurit dhe, shumë më rrallë, hemisferat dhe ventrikujt cerebrale (30). Pamja e tij më tipike është një kist me një nodus mural në rritje intensive, e cila shihet vetëm në 50% të rasteve. Kjo nuk është specifike për një astrocitomë pilocitare dhe mund të shihet në ganglioglioma dhe ksanthoastrocitoma pleomorfike. PA mund të shfaqet si një lezion solid me një qendër cistike-nekrotike në 40 deri në 45% të rasteve, ose si një lezion thjesht solid në 10% të rasteve. Pjesa solide e tumorit është hipodense në CT dhe herë pas here calcifikuar. Është iso-/hipointense në T1WI dhe hiperintens në T2WI. Rritet intensivisht me kontrast, herë pas here në mënyrë heterogjene në MR. Në imazhet diffusion weighted, ADC rritet pasi tumori është pauciqelizor. Në imazhin e perfuzionit, rCBV është i ulët, me një kurbë që ngrihet mbi bazën, duke reflektuar ndërprerjen e barrierës hematoencefalike. Ky kist ka herë pas here një përmbajtje të lartë proteine ose hemorragjike dhe muri i kistit herë pas here rritet në mënyrë homogjene, shpesh nëse parenkima cerebrale ngjitur është e infiltruar ose nëse ka ndodhur hemorragji brenda kistit. Glioma e traktit optik është një

astrocitomë pilocitare, e cila zhvillohet në rajonin e hipotalamusit, kiazmës optike ose nervave optike dhe përbën 5% të tumoreve të fëmijërisë (31). Pesëmbëdhjetë përqind e pacientëve me NF1 zhvillojnë një glioma të traktit optik (OTG) dhe një e treta e pacientëve me astrocitomë pilocitare të nervit optik kanë NF1, ndërsa përfshirja e traktit vizual të pasmë zakonisht shihet jashtë NF1. OTG karakterizohet nga shqetësime vizuale dhe endokrine (pubertet i hershëm). Shfaqet si një masë ovale ose e rrumbullakët multilobulare, me shtrirje superiore në ventrikulin e tretë, ventrikulin inferior ose sella turcica, prapa në fosën interpedunkulare dhe anteriorisht në fosën cerebrale anteriore. Zhvillohet përgjatë traktit optik anterior dhe posterior, por herë pas here ndodhet në rajonin hipotalamik-kiazmal. Përhapja meningeale është e rrallë dhe zakonisht ndodh pas operacionit. Rritja e kontrastit ndryshon dhe herë pas here shihet vetëm në pjesën periferike të lezionit. Astrocitoma pilomyxoid është një formë më agresive e sëmundjes (shkalla 2) dhe zakonisht gjendet në rajonin suprasellar tek fëmijët e vegjël. Duhet të merret parasysh tek foshnjat ose fëmijët e vegjël, veçanërisht nëse lezioni është hemorragjik (25% e rasteve) me rritje intensive të kontrastit (32).

## **2.2 Glioma të tjera**

Xantoastrocitoma pleomorfike është një tumor i gradës 2, i cili herë pas here është anaplastik (grada 3) dhe zakonisht shihet tek adoleshentët dhe të rinjtë mbi 20 vjeç. Është një tumor kortikal i cili ndodhet në regjionin temporal (49%) parietal, frontal ose oksipital dhe shkakton epilepsi. Shihet si një kist me një nodus të murit periferik dhe ngjitje meningeale ose durale në 2/3 e rasteve ose herë pas here si një lezion thjesht solid. Kalcifikimet janë të rralla. Pjesët solide periferike të tumorit janë izointense në T2WI dhe rriten me gadolinium (përmirësimi përshkruhet si "meningocerebral").

Glioma e gradës 2 (astrocitoma fibrilare difuze)

Glioma e gradës 2 (astrocitoma fibrilare difuze) (Fig. 2) zhvillohet kryesisht në lobet frontale dhe temporale dhe është një lezion infiltrativ homogjen pa edemë ose hemorragji përreth. Është hipodens në CT, hipointens në T1WI dhe hiperintens në T2WI dhe nuk rritet me gadolinium (33).

## **2.3 Glioma anaplastike (astrocitoma, oligoastrocitoma)**

Gliomat anaplastike (astrocitoma, oligoastrocitoma) janë të gradës 3, dhe kanë të njëjtën pamje, megjithëse me imazh më heterogjen. Mioinositoli shfaqet më i ulët se në gliomat e gradës së ulët në MRS.

## **2.4 Glioblastomat (grada 4)**

Glioblastomat (grada 4) janë të rralla tek fëmijët. Ky është një lezion nekrotik hemorragjik, i cili rritet pas injektimit të gadoliniumit. Kolina është rritur, laktati dhe

lipidet janë të pranishme, rCBV është rritur dhe ADC është i ulët. Këto glioma malinje shihen edhe në bërthamat gri të thella. Vendet anaplastike fokale sugjerohen nga një zonë hemorragjike ose nga shtimi i kontrastit. Ndonjëherë është e vështirë të dallohen zyrtarisht shkallët e ndryshme të gliomave në MR (34).

## **2.5 Oligodendrogliomat**

Oligodendrogliomat janë tumore të rrallë të gradës 2 që përbëjnë nën 2.5% të tumoreve të fëmijërisë, të cilat shfaqen rreth adoleshencës. Shihen forma më agresive anaplastike të tumorit (shkalla 3). Ato janë të lokalizuara në regjionet frontale (50-85%) dhe temporale në korteksin dhe lëndën e bardhë ngjitur, ose në bërthamat gri qendrore dhe talamusin, dhe kanë një prognozë më të dobët. Ato karakterizohen nga epilepsi, RICP dhe deficite neurologjike (35). Lezioni është hipodenz me kalcifikime në 40% të rasteve (më pak se tek të rriturit). Sinjali është hipointens në imazhet T1 weighted dhe hiperintens në imazhet T2, herë pas here me kiste të vogla. Rritja e kontrastit është e rrallë tek fëmijët, siç është efekti mase ose edema, përveç tumoreve anaplastike. ADC është rritur. Diagnoza diferenciale është me displazitë dhe DNET (36).

## **2.6 Glioma angiocentrike**

Glioma angiocentrike është një lezion kortiko-subkortikal, i cili karakterizohet nga epilepsi parciale refraktare tek fëmijët nga 2 deri në 14 vjeç. Lokalizohet në regjionin temporal në 38% të rasteve, frontal në 25%, parietal në 10% dhe oksipital në 8%. Lezioni i shkallës 1 mund të mbetet i qëndrueshëm ose të rritet në madhësi ngadalë. Ajo është e përcaktuar qartë, nuk rritet dhe ndodhet në korteks me shtrirje drejt ventrikulit. Tumori është hipointens në T1WI dhe hiperintens në T2WI dhe FLAIR, pa rritje të kontrastit. Tiparet më karakteristike raportohen të jenë shtrirja e lezionit drejt ventrikujve laterale në T2WI dhe FLAIR dhe një buzë kortikale hiperintense në T1WI (37).

## **2.7 Astrocitoma me qeliza gjigante**

Astrocitoma me qeliza gjigante është një lezion intraventrikular benign i gradës 1 që zhvillohet afër foramen Monro dhe mund të prodhojë hidrocefal akute obstruktive. Shihet pothuajse vetëm në sklerozën tuberoze, në 15% të pacientëve nën moshën 20 vjeç. Stigmat e tjera të sëmundjes përfshijnë: tuberozitetet kortikalë, noduset subependimale dhe linjat e migrimit radial në lëndën e bardhë. Ai paraqitet si një masë e rastësishme multifokale që përmban kalcifikime të cilat janë hipo-/izointense në T1 dhe iso-/hiperintense në imazhet T2, duke u rritur fuqishëm me gadolinium. Duhet dalluar nga një nodul subependimal, nga i cili mund të zhvillohet, nga madhësia e tij që është mbi 10/12 mm. Madhësia e tumorit mund të reduktohet nga trajtimi me everolimus (38).

## **2.8 Glioma e trungut të trurit**

Glioma e trungut të trurit përbën 10 deri në 20% të tumoreve cerebrale të fëmijërisë dhe 20 deri në 25% të tumoreve infratentoriale. Dy lloje të paraqitjes gjenden në MR, të cilat kanë një prognozë të ndryshme: difuze (më e zakonshme) dhe fokale (prognozë më e mirë).

## **2.9 Glioma difuze intrinseke pontine**

Glioma difuze intrinsike pontine përbën 60 deri në 80% të tumoreve pontine dhe 75% gjenden para moshës 10 vjeçare. Këto kanë një prognozë shumë të keqe, me një jetëgjatësi jo më shumë se një vit. Shenjat klinike janë një kombinim i përfshirjes së nervit kranial, veçanërisht VI dhe VII, një sindromë piramidale dhe ataksi. Këto janë, në përgjithësi, glioma fibrilare të grades 2, megjithëse tumoret i nënshtrohen rrallë biopsisë për shkak të rrezikut të komplikacioneve. Ato janë të vështira për t'u parë në CT dhe tregohen vetëm nga efekti masë, që prodhojnë në ventrikulin e katërt. Në MR, ato shfaqen si një lezion i madh infiltrues pontin (39) i cili mund të shtrihet vertikalisht, në cerebellum dhe përpara, duke rrethuar arterien bazilare. Ato janë hipo-/izointense në T1 dhe hiperintense në imazhet T2 dhe FLAIR, tregojnë pak ose aspak përmirësim me gadolinium dhe kanë një ADC të lartë. Transformimi në një shkallë më të lartë (3 dhe 4) reflektohet nga zhvillimi i rritjes së kontrastit, hemorragjia, një zonë me ADC të reduktuar, rCBV e rritur ose në MRS nga një rritje e kolinës dhe prania e lipideve (40).

## **2.10 Tumori neuronal disembrioplastik (DNET)**

